

**STATUTI SHOQËRISË ANONIME PA OFERTË PUBLIKE
"ALBTELECOM"**

KREU I

EMËRTIMI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 - Emërtimi i shoqërisë

Krijohet shoqëria anonime emërtuar "ALBTELECOM" Sh.A.

Neni 2- Selia e shoqërisë

- 2.1. Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga "Myslym Shyri", Nr. 42, Tirane.
- 2.2. Asambleja e Ortakëve mund të caktojë ose mbyllë seli dytësore në Shqipëri dhe jashtë saj.
- 2.3. Drejtoria mund të caktojë ose mbyllë çdo zyrë tjetër pa përfaqësi të përhershme, në Shqipëri ose jashtë saj.
- 2.4. Në lidhje me marrëdhëniet midis Shoqërisë dhe ortakëve, vendbanimi i secilit prej ortak është ai i vendosur në regjistrin e ortakëve.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar.

KREU II

OBJEKTI

Neni 4 – Objekti

- 4.1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është aktiviteti i gjithë shërbimeve të telekomunikacioneve, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për telekomunikacionet, në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 4.2. Shoqëria sipas legjislacionit në fuqi, do të kryejë çdo veprim tregtar dhe financiar që lidhet drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu

zgjerimin e aktivitetit, krijimin e shoqërive të reja, si edhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

4.3. Në pajtim me Legjislacionin Shoqëtar, për të arritur qëllimet e sipërpërmendura, Shoqëria mund:

- të marrë përsipër transaksione në lidhje me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënës ose hipotekor, cili mund të konsiderohet i përdorshëm ose i nevojshëm nga Drejtoria në mënyrë që të përmbushet qëllimi i Shoqërisë, me kusht që këto aktivitete të mos shtrihen më gjerë sesa parashikohet më lart;
- të kryejë aktivitete botuese dhe reklamuese;
- të nënshkruajë obligacione dhe garanci të çdo lloji, duke përfshirë garanci pagese për kambiale;
- të zotërojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, interesa në shoqëri të tjera të cilat kanë qëllime të ngjashme me ato të Shoqërisë, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

KREU III KAPITALI THEMELTAR – AKSIONET

Neni 5 – Kapitali themeltar i shoqërisë

- 5.1. Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i paguar i Shoqërisë është 15,000,000,000 lekë që përbëhet nga 15,000,000 aksione me vlerë nominale 1,000 (një mijë) lekë secili. Çdo aksion është i pandashëm dhe siguron të drejtën e një vote.
- 5.2. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, aksionet e reja i ofrohen me të drejtë zgjedhje ortakëve në proporcion me numrin e aksione që këta zotërojnë sipas nenit 155 e neneve vijues të ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” (“Ligji”).
- 5.3. Drejtoria mund të urdhërojë emetimin e nje çertifikate të re në vend të çertifikatave të emetuara deri në atë kohë nga Shoqëria me pretendimin se janë humbur ose shkatërruar. Kur kryhet autorizimi i emetimit të një çertifikate të re, Drejtoria, në diskrecionin e saj dhe si kusht paraprake për emetimin e saj, mund të përcaktojë kushte dhe afate të tilla që i quan të përshtatshme dhe dëmshpërblime që i konsideron të duhura me qëllim që të mbrojnë Shoqërinë nga çdo pretendim në lidhje me çertifikatën që pretendohet se ka humbur ose është shkatërruar.

KREU IV ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Neni 6 – Asambleja e Ortakëve

- 6.1. Asambleja e Ortakëve është organi vendimmarrës i Shoqërisë, i cili përbëhet nga aksionarët e Shoqërisë. Asambleja e Ortakëve mund të jetë e Zakonshme ose e Jashtëzakonshme. Asambleja e Ortakëve mund të zhvillohet në çdo vend tjetër të ndryshëm nga selia e shoqërisë, në Shqipëri.
- 6.2. Asambleja e Ortakëve thirret nga Kryetari i Këshilit Mbikqyrës ose nga Kryetari i Drejtorisë. Asambleja mund të thirret edhe në përputhje me parashikimet e nenit 132 të Ligjit.
- 6.3. Thirrja e Asamblesë së Ortakëve rregullohet nga Ligji.
- 6.4. Asambleja e Ortakëve do të thirret rregullisht dhe në rast se formalitetet për thirrjen e saj nuk janë respektuar, me kusht që Ortakët aktualë të jenë të pranishëm apo të përfaqësuar me prokurë.
- 6.5. Të gjitha Asambletë e Ortakëve drejtohen nga Kryetari i Drejtorisë ose në vend të tij nga Zv. Kryetari, ose, në rast se këto persona nuk janë të disponueshëm, nga një Anëtar i Drejtorisë ose edhe nga një ortak që caktohet nga Asambleja e Ortakëve. Asambleja e Ortakëve cakton një sekretar për mbledhjen, i cili/a mund të jetë ose jo ortak.
- 6.6. Aksionarët mund të vendosin që të përfaqësohen në Asamblenë e Ortakëve, me prokurë me shkrim, nga një aksionar tjetër ose nga bashkëshorti/ja e tij/saj. Megjithatë, secili aksionar apo palë e tretë nuk mund të përfaqësojë më shumë se tre aksionarë.
- 6.7. Kryetari ka të gjitha kompetencat për të verifikuar prokurat dhe rregullsinë e tyre, të drejtat e aksionarëve dhe të përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamblenë e Ortakëve dhe të caktojë nëse kjo e fundit është thirrur rregullisht dhe nëse është i pranishëm kuorumi i aksionarëve për të marrë vendime të vlefshme; ai ka edhe të drejtë të drejtojë diskutimet si dhe të përcaktojë metodat dhe procedurat lidhur me votimin.
- 6.8. Procesverbali i mbledhjes firmoset nga Kryetari i Asamblesë dhe nga sekretari/ja.

Neni 7 – Asambleja e Zakonshme

- 7.1. Asambleja e Zakonshme e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda gjashtë muajve nga mbyllja e vitit ushtrimor, me qëllim që të diskutohen, shqyrtohen dhe të miratohen deklaratat financiare të vitit të mëparshëm ushtrimor.
- 7.2. Asambleja e Zakonshme e Ortakëve quhet e thirrur rregullisht me njoftimin e parë me pjesëmarrjen e Aksionarëve, të pranishëm apo të përfaqësuar, që kontrollojnë të paktën 25% (njëzet e pesë përqind) të aksioneve me të drejtë vote. Në rast se në mbledhje nuk krijohet ky kuorum, do të thirret një mbledhje e dytë, pa qenë i

nevojshëm krijimi i kuorumit, Asambleja e Zakonshme e Ortakëve merr vendime me shumicë votash të aksionarëve, të pranishëm ose të përfaqësuar.

Neni 8 – Asambleja e Jashtëzakonshme

- 8.1 Vetëm Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve mund të marrë vendime lidhur me ndryshimin e të gjitha parashikimeve të e statutit.
- 8.2 Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve quhet e thirrur rregullisht me njoftimin e parë me pjesëmarrjen e Aksinerëve, të pranishëm apo të përfaqësuar, që kontrollojnë të paktën 50% (pesëdhjetë përqind) të aksioneve me të drejtë vote, dhe në njoftimin e dytë me pjesëmarrjen e Aksionarëve, të pranishëm apo të përfaqësuar, që kontrollojnë të paktën 25% (njëzetepesë përqind) të aksioneve me të drejtë vote.
- 8.3 Në rast se ky kuorum nuk krijohet, njoftimi i dytë i mbledhjes mund të shtyhet në një datë tjetër, por jo më vonë se dy muaj nga data kur është thirrur mbledhja e parë.
- 8.4 Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve merr vendime me shumicë prej $\frac{3}{4}$ (tre/të katërta) të aksionarëve, të pranishëm ose të përfaqësuar.

KREU V ADMNISTRIMI I SHOQËRISË KËSHILLI MBIKQYRËS

Neni 9 – Përbërja dhe Emërimi i Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

- 9.1 Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë. Pa cënuar sa citohet në Nenin 22.1, 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve emërohen nga Asambleja e Ortakëve ndërsa 1/3 (një e treta) e anëtarëve emërohet nga të punësuarit e shoqërisë, në pajtim me Ligjin.
- 9.2 Kohëzgjatja e detyrës së tyre është 2 (dy) vjet me të drejtë rizgjedhje. Anëtarët që emërohen nga Asambleja e Ortakëve mund të revokohen për çfarëdo arsye nga Asambleja e Zakonshme e Ortakëve. Anëtarët e emëruar nga të punësuarit e shoqërisë mund të revokohen në përputhje me dispozitat ligjore.
- 9.3 Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë persona fizikë.
- 9.4 Në rast vdekjeje, heqje nga detyra apo dorëheqje, vendet e lira të anëtarëve duhet të zëvendësohen brenda jo më shume se 3 muaj. Anëtari i Këshillit Mbikqyrës që caktohet për të zëvendësuar një anëtar tjetër, do qëndrojë në detyrë për kohën e mbetur nga mandati i anëtarit paraardhës.

9.5 Në pajtim me ligjin, Asambleja e Ortakëve mund të caktojë shpërblime për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës.

Neni 10 - Kryetari dhe Zv. Kryetari i Këshillit Mbikqyrës

- 10.1 Këshilli Mbikqyrës emëron midis anëtarëve të tij Kryetarin dhe Zv. Kryetarin të cilët kanë si detyrë thirrjen e mbledhjeve të Këshillit si dhe drejtimin e diskutimeve. Ata emërohen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit të tyre dhe mund të rizgjidhen.
- 10.2 Kryetari dhe Zv. Kryetari i Këshillit Mbikqyrës mund të përfitojnë kompensim shtesë, të caktuar nga Këshilli.
- 10.3 Këshilli Mbikqyrës mund të caktojë një sekretar/re edhe jashtë anëtarëve të tij.
- 10.4 Në rast mungese të Kryetarit, mbledhjet e Këshillit do të drejtohen nga Zv. Kryetari.

Neni 11 – Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës

- 11.1 Këshilli Mbikqyrës mbledhet zakonisht të paktën një herë në tre muaj si edhe sa herë që e kërkon interesi i shoqërisë, me kërkesë të Kryetarit, ose në mungesë të tij, nga Zv. Kryetari.
- 11.2 Thirrja do të kryhet 3 (tre) ditë përpara mbledhjes, me letër, telegram, telex ose telefax. Thirrja do të quhet e vlefshme edhe nëse komunikohet gojarisht dhe pa respektuar afatin kohor në rast se Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës e pranojnë këtë.
- 11.3 Çdo thirrje përmban rendin e ditës që propozohet për mbledhjen.
- 11.4 Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës do të zhvillohen në selinë e Shoqërisë apo në cdo vend tjetër që do të përcaktohet në njoftimin e mbledhjes.
- 11.5 Për çdo mbledhje të Këshillit Mbikqyrës, hartohet një procesverbal i cili përmban:
 - data dhe vendin e mbledhjes;
 - mënyren e thirrjes;
 - rendin e ditës;
 - drejtuesin e mbledhjes;
 - përmbledhjen e dokumenteve dhe të raporteve që paraqiten në mbledhje;
 - përmbledhjen e diskutimit;
 - rezultatet e votimit.

Procesverbali do të mbahet në një regjistër të posaçëm. Anëtarët që janë të pranishëm në mbledhje do të firmosin procesverbalin.

- 11.6 Vendimet e Këshillit Mbikqyrës do të shënohen në procesverbalin e mbledhjes në përputhje me dispozitat në fuqi, nga Kryetari dhe Zv. Kryetari.
- 11.7 Këshilli Mbikqyrës nuk mund të marrë vendime të vlefshme pa praninë e të paktën 1/2 e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast numër votash të barabarta, vota e Kryetarit është vendimtare. Këshilli Mbikqyrës mund të organizojë gjithashtu mbledhje dhe të marrë vendime të vlefshme nëpërmjet komunikimeve me shkrim, faks, postë elektronike dhe shërbime postare.

Neni 12 – Kompetencat e Këshillit Mbikqyrës

- 12.1 Këshilli Mbikqyrës cakton anëtarët e Bordit të Drejtorëve me miratimin e jo më pak së ½ (një e dyta) e të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, duke caktuar njërin prej tyre si Kryetar të bordit, i cili është përgjegjës për mbikqyrjen e politikave dhe të aktiviteteve të shoqërisë .
- 12.2 Këshilli Mbikqyrës ka përgjegjësinë për të siguruar që operacionet dhe aktivitetet e shoqërisë të jenë në përputhje me dispozitat ligjore. Ai rishikon dhe mbikqyr çdo situatë aktuale ose të mundshme të konfliktit të interesave dhe, në përputhje në pajtim me ligjin, merr nga anëtarët e Drejtorisë të gjitha njoftimet për konfliktet e interesit ose interesat materiale të mundshme ose aktuale që mund të kenë në lidhje me Shoqërinë. Këshilli Mbikqyrës udhëzon për mbrojtjen e sekretit dhe konfidencialitetit të informacionit për sa i përket Shoqërisë dhe kontrollon zbatimin e tyre.
- 12.3 Këshilli Mbikqyrës është i autorizuar të kryejë në kohë të gjitha verifikimet dhe inspektimet që konsideron të nevojshme për përmbushjen e detyrës së tij.
- 12.4 Këshilli Mbikqyrës i paraqet Asamblesë së Ortakëve komentet e tij në lidhje me raportin vjetor që përgatit Drejtoria sipas nenit 130 të Ligjit.

KREU VI ADMINISTRIMI I SHOQËRISË DREJTORIA

Neni 13 – Drejtoria

- 13.1 Drejtoria përbëhet nga një Drejtor, person fizik. Drejtoria administron shoqërinë. Këshilli Mbikqyrës mund të vendosë për ndryshimin e numrit të anëtarëve të

Drejtorisë. Në këtë rast Këshilli Mbikqyrës merr vendim në lidhje me marrëdhënien midis anëtarëve të Drejtorisë.

- 13.2 Drejtorja emërohet nga Këshilli Mbikqyrës kur janë dakort të paktën ½ (një e dyta) e të gjithë anëtarëve të tij.
- 13.3 Anëtarët e Drejtorisë janë persona fizikë, në të kundërt emërimi i tyre është i pavlefshëm. Ata nuk mund të zgjidhen midis të punësuarve në shoqëri. Nëse një anëtar i Këshillit Mbikqyrës emërohet anëtar i Drejtorisë, mandati i tij në Këshillin Mbikqyrës përfundon. Një person nuk mund të emërohet anëtar Drejtorie ose Drejtor në më shumë se një shoqëri.
- 13.4 Anëtarët e Drejtorisë mund të shkarkohen nga Këshilli Mbikqyrës për shkaqe të përligjura.
- 13.5 Anëtarët e Drejtorisë emërohen për një periudhë kohore prej 2 (dy) vjetësh.
- 13.6 Përfaqësuesit ligjorë të mësipërm të shoqërisë mund të emërojnë përfaqësues "ab negotia" për kryerjen e detyrave të posaçme ose kategorive funksionesh, në kufijtë e kompetencave të dhëna.
- 13.7 Paga e anëtarëve të Drejtorisë caktohet nga Këshilli Mbikqyrës në aktin e emërimit të tyre.

Neni 14 – Të drejtat dhe detyrat e Drejtorisë

- 14.1 Drejtorja përfaqëson shoqërinë në lidhje me të tretët.
- 14.2 Drejtorja ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të Shoqërisë me përjashtim të rasteve për këto kompetenca i përkasin Asamblesë apo Këshillit Mbikqyrës.
- 14.3 Aktet me të cilat Shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve duhet të nënshkruhen nga anëtari me cilësinë e Drejtorit ose nga personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këtë akt.
- 14.4 Anëtarët e Drejtorisë janë përgjegjës për për ushtrimin e duhur të funksioneve që i janë caktuar Drejtorisë dhe për zbatimin e vendimeve të Këshillit Mbikqyrës.
- 14.5 Drejtorja është përgjegjëse në raportimin ndaj Këshillit Mbikqyrës. Ajo duhet të paraqesë raportet Këshillit Mbikqyrës në intervale të rregullt, të paktën çdo tre muaj. Për më tepër, Drejtorja duhet t'i raportojë Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës për çdo rast tjetër të veçantë.
- 14.6 Drejtorja është përgjegjëse në dhënien e informacionit Këshillit Mbikqyrës për aspekte të menaxhimit të biznesit të shoqërisë.



Neni 15 – Ruajtja e sekretit

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, Drejtorisë si edhe punonjësit e tjerë të shoqërisë detyrohen të ruajnë sekretin edhe pas largimit nga shoqëria për të dhënat që kanë karakter të brendshëm të cilat janë përcaktuar e miratuar nga Drejtoria dhe ju janë bërë të njohura punonjësve.

Neni 16 – Marrëveshjet ndërmjet Shoqërisë dhe Drejtorisë ose një Anëtari të Këshillit Mbikqyrës

- 16.1 Çdo marrëveshje ndërmjet shoqërisë dhe anëtarëve të Drejtorisë ose një anëtari të Këshillit Mbikqyrës, qoftë e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë duhet t'i nënshtrohet autorizimit paraprak të Këshillit Mbikqyrës.
- 16.2 Përcaktimi i mësipërm është i vlefshëm edhe për marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe një shoqërie tjetër, kur një anëtar i Këshillit Mbikqyrës është edhe anëtar i Këshillit Mbikqyrës të një shoqërie tjetër, me të cilën propozohet të lidhet marrëveshje. Kjo nuk është e zbatueshme për marrëveshjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë rrjedhëse të shoqërisë që kryhen në kushte normale.
- 16.3 Anëtari i Drejtorisë ose i Këshillit Mbikqyrës i interesuar duhet të njoftojë Këshillin Mbikqyrës për një marrëveshje për të cilën zbatohen kërkesat e këtij neni të statutit. Anëtari i interesuar i Këshillit Mbikqyrës nuk merr pjesë në votimin për dhënien e autorizimit.

KREU VII

KONTROLLI, USHTRIMI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, FITIMET


Neni 17 – Ekspertët kontabël të autorizuar

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga dy ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen për një ushtrim financiar.

Neni 18 – Ushtrimi financiar – Inventari – Llogaritë Vjetore

- 18.1 Ushtrimi financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 18.2 Drejtoria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore. Në mbyllje të ushtrimit financiar, Drejtoria harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin

financiar. Drejtoria përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar.



Neni 19 – Rezultati i Vitit Ushtrimor dhe Përcaktimi i Fitimit

- 19.1 Drejtoria harton bilancin e ushtrimit vjetor në pajtim me kërkesat ligjore. 5% e fitimeve që rezultojnë nga bilanci i vitit ushtrimor i miratuar sipas parashikimeve të Ligjit hiqet për të krijuar rezervën e domosdoshme derisa rezerva e domosdoshme të jetë e barabartë me 10% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 19.2 Fitimi i mbetur shpërndahet në përputhje me vendimet e Asamblesë së Ortakëve në lidhje me shpërndarjen e dividendëve ose caktime të tjera.

Neni 20 – Likuidimi dhe prishja

- 20.1 Shoqëria konsiderohet e prishur me realizimin e ngjarjeve të parashikuara sipas Ligjit. Në rast prishje, Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve cakton një ose më shumë likuidatorë, duke ju dhënë atyre kompetencat përkatëse.
- 20.2 Shoqëria gjithashtu mund të priset apo bashkohet me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve, pa çënuar parashikimet e nenit 21.3 dhe 21.4 në rast bashkimi.

Neni 21 – Dispozita kalimtare

- 21.1 Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (në vijim “Ministria”) deri në momentin që do të zotërojë të paktën 10% (dhjetë për qind) të aksioneve të Shoqërisë dhe në çdo rast për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh duke filluar nga data 28 Shtator 2007, do të ketë të drejtë të caktojë emrin e 1 (një) anëtarit të Këshillit Mbikqyrës së Shoqërisë, pa paragjykim ose kufizim, në rast se ka, sipas parashikimeve të Ligjit ose dispozitave të tjera ligjore të legjislacionit shqiptar.
- 21.2 Në rast transferimi *inter vivos* të aksioneve të Shoqërisë, Ministria do të ketë të drejtë të shprehë miratimin e saj për transferimin e propozuar për 5 (pesë) vjet duke filluar nga data 28 Shtator 2007. Për këtë arsye, aksionari që synon të transferojë aksionet e tij duhet t’i komunikojë me shkrim Ministrisë identitetin e subjektit në favor të të cilit do të kryhet transferimi dhe kushtet e transferimit. Ministria duhet të shprehë miratimin në lidhje me subjektin përfitues të transferimit, miratim i cili nuk duhet të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme, brenda 20 (njetëzetë) ditëve duke filluar nga data e marrjes e komunikimit të sipërpërmendur, dhe në rast se miratimi përkatës nuk është dhënë brenda këtij afati, subjekti përfitues i transferimit do të konsiderohet si i refuzuar. Transferimi i aksioneve pa miratimin e Ministrisë do të konsiderohet si i pavlefshëm dhe

asionari do ti paguajë Ministrisë një kusht penal prej 5.000.000 (pesë milion) Euro.

- 21.3 Në rast se Shoqëria do të bashkohet me shoqëri të tjera, pjesa e kapitalit themeltar e shprehur në përqindje të shoqërisë në zotërim të Ministrisë si rezultat i rritjes së kapitalit nuk duhet të jetë e ndryshme nga pjesa e kapitalit themeltar e shprehur në përqindje të Shoqërisë e zotëruar aktualisht nga Ministria.
- 21.4 Në rast se kapitali themeltar i Shoqërisë është rritur brenda një periudhe kohore prej 1 (një) viti duke filluar nga 28 Shtatori 2007, pjesa e aksioneve e shprehur në përqindje e kapitalit themeltar të zotëruar nga Ministria si rezultat i rritjes së kapitalit nuk duhet të jetë e ndryshme nga pjesa e aksioneve e shprehur në përqindje e zotëruar aktualisht nga Ministria në Shoqëri.